

VENDIM
Nr. 185, datë 20.11.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “KRITEREVE PËR TË VENDOSUR KUFIZIME, SIPAS KËRKESAVE PËR LIDHJEN E MODULEVE TË GJENERIMIT”

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; parashikimeve të vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.1.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë; neneve 60, 61, 62, 63, 64 dhe 65 të Rregullores së Komisionit (KE) 2016/631, datë 14 prill 2016; nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë e ERE me nr. 102/9 prot., datë 12.11.2019, “Për fillimin e procedurës për miratimin e ‘Kritereve për të vendosur kufizime sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit””,

konstatoi se:

- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 1.7.2006;
- Transpozimi, si dhe zbatim i kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit që dalin nga institucionet Evropiane është një nga aktivitetet kryesore të punës së institucioneve përkatëse në Shqipëri.
- Autoriteti rregullator (ERE) duhet të specifikojë kriteret për vendosjen e derogimeve (kufizimeve), sipas përcaktimeve të neneve 62 dhe 63 të rregullores së publikuar nga ENTSO-E, pasi të konsultohet me operatorët përkatës të sistemit dhe zotëruesit e objektit gjenerues të energjisë elektrike si dhe pjestarë të tjerë të tregut të energjisë elektrike, të cilët vlerëson se mund të preken nga këto rregulla.
- Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike OST sh.a. është anëtar me të drejta të plota e ENTSO-E.
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, kjo rregullore miratohet nga ERE, si detyrë që buron nga Rregullorja e Komisionit Evropian (KE) 2016/631, datë 14 prill 2016.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën miratimin e “Kritereve për të vendosur kufizime, sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit.

2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti